Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Državna Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka
National Agency for Protection of Personal Data

Raporti Vjetor i Punës

MARS, 2014

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Državna Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka
National Agency for Protection of Personal Data

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2013

PRISHTINË
Mars, 2014

Fj*ala e Mbikëqyrësit Kryesor Shtetëror*

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, para Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të saj, për herë të dytë del me raportin e saj të punës njëvjeçare, duke shënuar progres domethënës*. Raporti është vazhdimësi e raportimit standard ne kete fushe,qe do te plotesohet me te arritura dhe te dhena konkrete te v.2013.*

Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në parim, është pjesë përbërëse e lirive fundamentale të drejtave të njeriut, njëhefrit është parim bazë i Deklaratës Univerzale të të Drejtave të Njeriut të OKB-së dhe direkt ndërlidhet me Konventen 108 të vitit 1981.

Në përputhje me Kushtetututën e Republikës së Kosovës, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si institucion mandatar për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në të gjitha institucionet e vendit tonë, ka shënuar rezultate të prekshme dhe kurajuese. Agjencia, gjatë vitit 2013 ka arritur të anëtarësohet në Mekanizmin Ndërkombëtar të Mbrojtjes së të Dhënave Personale dhe të Privatësisë me të drejta të plota dhe atë të Autoriteteve Evropiane të Mbrojtjes së të Dhënave Personale si Vëzhgues i Përhershëm.

Hartimi i këtij raporti për periudhën e vitit 2013, pasqyron angazhimin e madh të Këshillit të Agjencisë dhe stafit të saj. Raporti fokusohet në sfidat dhe përpjekjet për ngritjen e institucionit, të domosdoshëm në zhvillimet e reja të demokracisë, sundimit të ligjit, lirive dhe të drejtave themelore të njeriut zhvillimeve kolosale të teknologjisë së komunikimit njerëzor. Raporti synon të nxjerrë në pah detyrat ligjore, në njërën anë për institucionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtat e qytetarëve, që të kenë sa më tepër njohuri mbi të drejtat e tyre për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të privatësisë. **Ky raport** ***shënon progres në krahasim me vitin paraprak në sensibilizimin e mbrojtjes së të dhënave në Administratë Publike, Sistemin Bankar, Telekomunikacion, në sistemin e Arsimit etj., dhe ngritjen e vetëdijes te kontrollorët dhe te qytetarët. Ndërsa te hartimi i masës legjislative në nivel vendi, Agjencia trefish më shumë se në vitin paraprak, ka dhënë mendimet e veta lidhure me harmonizimin me ligjin e mbrojtjes së të dhënave personale. Ndërkaq raporti në vazhdim në fushën e inspektimeve me shifra konkrete nxjerr në pah të gjitha fushat inspektime të shumta dhe përmbushjen e të gjitha adresimeve të Raportit të Progresit të ndërlidhura me Mbrojtjen e të Dhënave Personale respektivisht me Agjencinë, në të dy sektorët.***

Agjencia, me përkushtim, në fund të këtij viti e ka forcuar aktivitetin e vetë në objektin shtetëror dhe punën e saj kryesisht e ka fokusuar në teren lidhur me zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, interes ky jetik i i qytetareve ,dhe në përgjithësi shoqërisë sonë dhe parimeve bazë të derivuara nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e OKB-se, Konventa për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut e KE-së, Konventa 108 e vitit 1981, Protokollet e saj. Në këtë drejtim bashkëpunimi ynë me të gjitha institucionet tona dhe shoqërinë civile në nivel vendi dhe institucionet relevante të KE-së, Komisionit Evropian dhe institucionet simotra në rajon është vazhdimësi e punës sonë për realizimin e objektivave tona programore. Raporti në fund nxjerr edhe vlerësimet e përgjithshme dhe rekomandimet për të ardhmen në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

Përmbajtja e Raportit

1. Hyrje 5
2. Korniza Ligjore 7
3. Përgjegjësitë dhe Autorizimet 8
3.1 Përgjegjësitë 8
3.2 Autorizimet. 9
3.3 Misioni 10
3.4 Vizioni 10
3.5 Aktet Nënligjore të Agjencisë 11
3.5.1 Akte Nënligjore 11
4. Raporti i Progresit - Liberalizimi i Vizave 12
5. Aktivitetet e Agjencisë në Fushën e Mbrojtjes së të Dhënave Personale 13
5.1 Organizimi i Agjencisë 13
5.1.1 Këshilli 13
5.1.2 Departamentet 13
5.2 Këshilla dhe Opinione 15
5.2.1 Projekt – Ligje 17
5.2.2 Projekt – Rregullore 18
5.2.3 Projekt - Udhëzime Administrative 18
5.2.4 Draft-Marrëveshje 19
5.2.5 Akte të tjera 20
5.3 Ankesat 21
5.4 Inspektimi dhe Kontrolli 23
5.4.1 Inspektime 24
5.4.2 Inspektime të rregullta 26
5.4.3 Inspektimet Sipas Ankesës 30
5.4.4 Inspektimet Sipas Detyrës Zyrtare 31
5.4.5 Kontrollet 32
5.4.6 Përpunimi i të dhënave biometrike 33
5.5 Transferimi i të Dhënave 34
5.6 Informimi dhe Promovimi 36
5.7 Bashkëpunimi Vendor dhe Ndërkombëtar 41
5.8 Caktimi i Zyrtarit Mbrojtës 43
5.9 Regjistrimi i Dosjeve dhe Vëzhgimi me Kamerë 45
5.9.1 Regjistrimi i Dosjeve 45
5.9.2 Vëzhgimi me Kamerë 45
5.10 Financat dhe Buxheti 46
5.11 Shpenzimet Buxhetore 47
6. Vlerësimet e Përgjithshme dhe Rekomandimet për Mbrojtjen e të Dhënave Personale 50

1. HYRJE

Në funksion të zhvillimeve të reja të teknologjisë dhe industrializimit të shpejtë të shoqërisë njerëzore, e veçmas teknologjisë së informimit e të telekomunikacionit, jeta e njeriut ka ndryshuar në kuptimin pozitiv për shpejtësinë dhe cilësinë e komunikimit në mes njerëzve në çdo pjesë të rruzullit tokësor. Ky zhvillim i shpejtë ndikoi që ndërhyrja në jetën private të njeriut të jetë e paevitueshme. Andaj duke qenë në mbështetje të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut të OKB-së, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, të Konventës 108 te vitit 1981 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Privatësisë gjatë përpunimit automatik të të dhënave personale, Direktivës 95/46 të vitit 1995 e drejta për mbrojtje të të dhënave personale dhe privatësisë është e drejtë themelore në kuadër të drejtave të njeriut, që është e domosdoshme për funksionimin e një shoqërie demokratike. Për më tepër, kjo e drejtë mbrohet me Kushtetutë dhe Ligjin për Mbrojtje të të Dhënave Personale edhe ne Republikën e Kosovës.

Në harmoni me nenin 44 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Agjencia me anë të këtij raporti paraqet para Kuvendit të Republikës së Kosovës një pasqyrë të përgjithshme të aktiviteteve të saj mbi zhvillimet në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale në vitin 2013 si dhe jep vlerësimet dhe rekomandimet lidhur me të.

Agjencia, përkundër vështirësive materiale teknike, zhvillimit të aktivitetit në ndërtesë jo adekuate private dhe kapaciteteve të kufizuara njerëzore, tani më ka arritur një funksionalizim evident për kryerjen të detyrave dhe obligimeve që burojnë nga Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Në fakt, Kosova i është bashkëngjitur familjes së madhe evropiane në festimin e 28 janarit, ditës së privatësisë, ku dhe ne me agjencitë homologe, kemi shënuar këtë ditë me aktivitete të ndryshme në bashkëpunim me Zyrën Ndërlidhëse Evropiane dhe shoqërinë civile.

Fushata për caktimin e zyrtarëve të brendshëm për mbrojtjen e të dhënave personale si në organet publike ashtu edhe në ato private në këtë periudhë raportuese ishte mjaft e suksesshme.
Kjo ka rezultuar me caktimin e këtij zyrtari nga një numër konsiderueshëm nga ana e organeve publike qendrore.

Me qëllim të zbatimit të ligjit në kuadër të kompetencave, Agjencia ka kryer inspektimet në harmoni me planin e punës, si dhe duke vepruar në rastet kur është vënë re shkelje e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Agjencia ka pranuar ankesa dhe një numër të konsiderueshëm të pyetjeve nga qytetarët dhe institucionet për çështje të ndryshme, e që kryesisht i dedikoheshin

Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, e që janë trajtuar dhe shpjeguar me profesionalizëm të plotë.

Gjatë vitit 2013 sipas planit të punës, Agjencia ka pasur detyrë parësore sensibilizimin e mëtejmë në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale tek organet publike dhe private ku për këtë qëllim janë organizuar seminare, punëtori dhe këshilla.

Me qëllim të ngritjes së ndërgjegjësimit të qytetarëve lidhur me të drejtat e tyre në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë, Agjencia ka botuar dhe publikuar broshura dhe video ndërgjegjësuese. Gjithashtu ka qenë e pranishme në mediumet e shkruara dhe elektronike, gjë që ndikoi pozitivisht në rrjedhat e tërësishme të mbrojtjes së të dhënave dhe privatësisë. Konsiderojmë se përkundër rezultateve të arritura, siç thamë, në ndërgjegjësimin e qytetarëve, nuk jemi të kënaqur me nivelin e të arriturave e që do të jetë si objektiv kryesor për vitin 2014.

2. KORNIZA LIGJORE

Në Republikën e Kosovës e drejta e mbrojtjes së të dhënave personale dhe e privatësisë është e drejtë e garantuar me Kushtetutë, sipas marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare dhe me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Kjo e drejtë e garantuar me nenin 36 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës përfshinë respektimin e jetës private dhe familjare, pacenueshmërinë e banesës, fshehtësinë e korrespondencës, telefonisë dhe komunikimeve të tjera dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Gjithashtu, zbatimi i drejtpërdrejtë i të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohet me nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, siç janë:

(1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;

(2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;

Në vitin 2010, Kuvendi i Kosovës aprovoi Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (03/L-172) i cili përcakton të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe themeloi institucionin që është përgjegjës për mbikëqyrjen e legjitimitetit të përpunimit të të dhënave.

Në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 22, pika 2 është ratifikuar Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokolleve të saj, ku me nenin 8 respektohet e drejta e privatësisë dhe jetës familjare.

Gjithashtu, në bazë të nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut janë drejtpërdrejt të aplikueshme edhe në vendin tonë.
Konventat dhe direktivat evropiane, të cilat rregullojnë fushën e mbrojtjes së të dhënave dhe privatësisë janë: Konventa 108/EC dhe protokollet shtesë (për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale); Direktiva 95/46/EC; Direktiva 2002/58/EC (e-privatësia dhe komunikimet elektronike); Direktiva 2006/24/EC. Konventat lartcekura ende nuk janë të ratifikuara nga ana e Kuvendit të Kosovës.

I gjithë legjislacioni primar dhe sekondar i cili rregullon përpunimin e të dhënave personale duhet të jetë në harmoni me nenin 36 të Kushtetutës të Republikës së

Kosovës dhe Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Në kuadër të kësaj duhet theksuar se në numrin më të madh të ligjeve të aprovuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës kanë arritur në konsultim tek Agjencia Shtetëror për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ne mbesim të përkushtuar që të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore të jenë në harmoni me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, konventat dhe direktivat të cilat rregullojnë përpunimin e të dhënave personale dhe mbrojtjen e privatësisë.

3. PËRGJEGJËSITË DHE AUTORIZIMET

3.1 Përgjegjësitë

Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është institucion shtetëror i pavarur i themeluar në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe është përgjegjëse për mbikëqyrjen e legjitimitetit të përpunimit të të dhënave personale. Agjencia kryesohet nga këshilli, i cili përbëhet nga mbikëqyrësi kryesor shtetëror dhe katër mbikëqyrës shtetëror, të cilët emërohen nga Kuvendi i Kosovës.

Agjencia këshillon Kuvendin e Kosovës, Qeverinë, organet e pushtetit lokal, organet e tjera shtetërore, ushtruesit e pushtetit publik si dhe institucionet private për të gjitha çështjet lidhur me mbrojtjen e të dhënave, duke përfshirë interpretimin dhe zbatimin e ligjeve përkatëse, që rregullojnë përpunimin e të dhënave personale.

Agjencia duhet të konsultohet nga Kuvendi i Kosovës dhe Qeveria e Kosovës, me rastin e hartimit të masave legjislative dhe administrative që kanë të bëjnë me përpunimin e të dhënave personale.

Agjencia vendos lidhur me ankesat e personave nëse ai ose ajo konsiderojnë se e drejta e tyre për mbrojtjen e të dhënave janë shkelur, dhe informon ankuesin lidhur me rezultatin dhe masat e ndërmarra; Jep pëlqimin lidhur me krijimin e sistemit të dosjeve si dhe krijon dhe mirëmban regjistrin e sistemit të dosjeve; Mbikëqyrë procedurat dhe masat e duhura organizative, teknike dhe logjiko-teknike për sigurimin e të dhënave personale; Kryen inspektime dhe kontrolle për të mbikëqyrur zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe të cilido ligj apo rregullore që rregullon përpunimin e të dhënave personale.

Agjencia bashkëpunon me organet shtetërore, ndërkombëtare dhe organet e Bashkimit Evropian lidhur me çështjet që konsiderohen të rëndësishme për mbrojtjen e të dhënave personale; Mbikëqyrë zbatimin e dispozitave lidhur me transferimin e të dhënave; Parashtron kërkesë te Gjykata Kushtetuese e Kosovës për të vlerësuar kushtetutshmërinë e ligjeve, rregulloreve dhe akteve tjera kur

konsideron se ato nuk janë në harmoni me të drejtën për mbrojtjen e të dhënave, siç parashihet në nenin 36 të Kushtetutës së Kosovës; Përpilon planin vjetor të punës si dhe paraqet para Kuvendit raportin vjetor të punës në lidhje me zhvillimet, vlerësimet dhe rekomandimet në fushën e mbrojtjes së të dhënave, si dhe të njëjtin e bën publik; Ja propozon Kuvendit buxhetin për nevojat vjetore të Agjencisë; Nxjerr akte nënligjore me qëllim të zbatimit të ligjit.

3.2 Autorizimet

Me qëllim të përmbushjes së detyrimeve ligjore, Agjencia kryen inspektime dhe kontrolle. Inspektimet dhe kontrollet realizohen vetëm nga mbikëqyrësit shtetërorë. Mbikëqyrësit kryejnë inspektime dhe kontrolle të rregullta, në bazë të detyrës zyrtare si dhe sipas ankesës. Në këtë kuadër mbikëqyrësit shtetërorë kanë të drejtë të kontrollojnë dhe konfiskojnë çdo dokumentacion që ka të bëjë me përpunimin e të dhënave personale, pavarësisht nga besueshmëria ose fshehtësia e tij; kontrollojnë përmbajtjen e sistemeve të dosjeve, pavarësisht nga besueshmëria ose fshehtësia e tyre dhe katalogët e sistemeve të dosjeve; kontrollojnë çdo dokumentacion dhe udhëzim që rregullon sigurinë e të dhënave personale; kontrollojnë ndërtesën në të cilën të dhënat personale përpunohen dhe kanë të drejtë të kontrollojnë dhe nëse konstatohen shkelje ligjore të konfiskojnë kompjuterët dhe çfarëdo pajisje tjetër, si dhe dokumentacionin teknik; verifikojnë masat dhe procedurat që kanë për qëllim sigurimin e të dhënat personale dhe zbatimin e tyre; kryejnë çdo detyrë tjetër që konsiderohet e rëndësishme për kryerjen e inspektimeve dhe kontrolleve të parapara me këtë ligj.

Nëse gjatë inspektimit dhe kontrollit, mbikëqyrësi vëren shkelje të këtij ligji ose të cilido ligj apo rregullore që rregullon përpunimin e të dhënave personale, ka të drejtë që menjëherë të urdhërojë eliminimin e parregullsive ose mangësive që ai ose ajo i vë re në mënyrën dhe brenda afatit të caktuar. Kjo mund të përfshijë asgjësimin, bllokimin, shkatërrimin, fshirjen ose anonimizimin e të dhënave personale në pajtim me ligjin; të ndalojë përkohësisht dhe në mënyrë të caktuar përpunimin e të dhënave personale nga kontrolluesit dhe përpunuesit në sektorët publik ose privat, të cilët kanë dështuar në zbatimin e masave dhe procedurave të nevojshme për sigurimin e të dhënave personale; të ndalojë përkohësisht dhe në mënyrë të caktuar përpunimin e të dhënave personale, anonimizimin e tyre, klasifikimin dhe bllokimin e të dhënave personale sa herë që ai ose ajo vjen në përfundim se të dhënat personale janë duke u përpunuar në kundërshtim me dispozitat ligjore; të ndalojë përkohësisht dhe në mënyrë të caktuar përpunimin/transferimin e të dhënave personale në vendet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare, ose zbulimin e tyre marrësve të huaj nëse ato janë transferuar ose zbuluar në kundërshtim me dispozitat ligjore ose me marrëveshjet ndërkombëtare; të paralajmërojë ose këshillojë me shkrim kontrolluesin e të dhënave ose përpunuesin e të dhënave në rastet e shkeljeve të vogla; në rast të parregullsive ose mangësive kontrolluesi i të dhënave ose

përpunuesi i të dhënave duhet që menjëherë t'i korrigjojë ato pas marrjes së udhëzimeve me shkrim ose këshillimit nga Mbikëqyrësit për të siguruar përpunim të ligjshëm të të dhënave.

3.3 Misioni

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke pasur status të pavarur, ka përgjegjësinë ligjore për mbikëqyrjen e legjitimitetit të përpunimit të të dhënave personale.

Këshillimi i organeve publike dhe private, marrja e vendimeve për ankesat e paraqitura, inspektimet dhe kontrollet, informimi i publikut, si dhe promovimi e përkrahja e të drejtave themelore për mbrojtjen e të dhënave personale janë pjesë e fushë veprimtarisë kryesore në kuadër të misionit të Agjencisë.

Me ndërmarrjen e këtyre aktiviteteve, Agjencia synon që e drejta e mbrojtjes së të dhënave personale dhe e privatësisë të çdo qytetari në Republikën e Kosovës të mbrohet dhe promovohet.

Me qëllim të mbrojtjes dhe promovimit të drejtës së mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë, bashkëpunimi ndërkombëtar është pjesë e rëndësishme e misionit të përhershëm të Agjencisë.

3.4 Vizioni

Me qëllim të përmbushjes së misionit të saj, sipas strategjisë së aprovuar, Agjencia synon të realizojë këto objektiva:

Harmonizimin e plotë të kornizës ligjore me EU Acquis Communautaire; ndërgjegjësimin i qytetarëve për të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë; mbikëqyrjen e ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave përmes inspektimeve dhe kontrolleve; thellimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të punëve me organet dhe institucionet tjera, si dhe me mekanizmat dhe institucionet ndërkombëtare, me qëllim të mbrojtjes dhe promovimit të së drejtës së mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë; ngritjen e profesionalizmit për stafin e Agjencisë, funksionalizimi i plotë i strukturës organizative si dhe sigurimi i hapësirave të punës në objekte shtetërore; fushatën njoftuese dhe ndërgjegjësuese për opinionin publik përmes aktiviteteve përkatëse; mbajtjen e takimeve, konferencave dhe nënshkrimi i marrëveshjeve me karakter rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale; regjistrimin e të gjitha dosjeve të institucioneve publike dhe private.

3.5 Aktet Nënligjore të Agjencisë

Në harmoni me nenin 47, 93 dhe 94 të Ligjit Nr. 03 /L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me qëllim të zbatimit të ligjit, Agjencia ka nxjerrë akte nënligjore dhe dokumentet përcjellëse administrative.

3.5.1 Akte Nënligjore

- *Aktet nënligjore*

1. Rregullore e punës së Agjencisë 20/2011.
2. Udhëzim Administrativ për caktimin e zyrtarit të mbrojtjes së të dhënave personale 01/2011,
3. Udhëzimi Administrativ për kartelat zyrtare të mbikëqyrësve shtetërorë 03/2012; (i miratuar nga Qeveria me propozim të Agjencisë konform nenit 47 të ligjit nr. 03/L-172)
4. Rregullore për mënyrën e kryerjes së inspektimit dhe kontrollit 01/2012;
5. Rregullore për mënyrën e mbajtjes së regjistrit të sistemit të dosjeve të të dhënave personale dhe formularit të regjistrit përkatës 02/2012;
6. Rregullore mbi procedure e brendshshme të shqyrtimit të kërkesave për lejimin e transferimit ndërkombëtar të të dhënave personale 03/2012.
7. Kodi i Etikës për punonjësit e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
8. Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës 01/2013.

- *Dokumente Përcjellëse*

1. Formulari i Ankesës.
2. Formulari i procesverbalit të Inspektimit dhe Kontrollit.
3. Formulari për lejimin e transferit ndërkombëtar të të dhënave.
4. Listën e Kontrollit
5. Formulari Kërkesë për Regjistrim të Kontrollorëve

4. RAPORTI I PROGRESIT - LIBERALIZIMI I VIZAVE

Në kuadër të shqetësimeve të ngritura si në raportet e progresit apo në vlerësimin e BE për liberalizimit e vizave – ASHMDHP ka kryer të gjitha detyrat të cilat i janë adresuar në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.
Në kuadër të rekomandimit të raportit të progresit Agjencia ka nxjerrë një mori të akteve të brendshme të cilat janë të përshkruara në kapitullin e harmonizimit të legjislacionit.
Gjersa ngritja e kapaciteteve të brendshme dhe kapaciteteve brenda organeve publiko-private është një proces i vazhdueshëm të cilin e kemi realizuar përmes organizimeve të trajnimeve në bashkëpunimi me IKAP dhe në organizimin e tryezave, seminareve dhe punëtorive. Në këtë drejtim mund të konstatojmë që mbi 104 zyrtarë për mbrojtjen e të dhënave personale e kanë kaluar tashmë trajnimin bazik për mbrojtjen e të dhënave personale dhe rreth 700 zyrtarë të tjerë nga Ministria e Punëve të Brendshme, në nivel vendi tashmë paraprakisht kishin ndjekur një trajnim të këtillë, gjersa mbi 1000 zyrtarë të lartë udhëheqës të departamenteve në kuadër të organeve private kanë qenë pjesë e seminareve dhe punëtorive me qëllim të ngritjes së vetëdijes së kontrolloreve lidhur me zbatimin e ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale.

Agjencia ka dëshmuar përkushtimin e saj për realizimin e të gjitha rekomandimeve të dala nga raporti i progresit. Një konstatim i tillë vlerësues vihet në pah në raportet e BE-së ku shprehet angazhimi dhe përkushtimi i autoritetit tonë në mbrojtjen dhe promovimin e mbrojtjes së të dhënave personale, si dhe përkushtimi i ynë në arritjen e standardeve Evropiane, duke kompletuar në masën e kënaqshme kornizën ligjore, duke ngritur kapacitet e nevojshme si dhe duke ndërmarr veprimet e nevojshme përmes inspektimeve, kontrolleve, këshillave dhe opinioneve në garantimin e drejtës së subjektit të të dhënave personale për mbrojtjen e privatësisë së tyre.

5. AKTIVITETET E AGJENCISË NË FUSHËN E MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

5.1 Organizimi i Agjencisë

Organet e Agjencisë janë Këshilli dhe Departamentet.

5.1.1 Këshilli

Agjencia kryesohet nga Këshilli pesë anëtarësh të cilët emërohen nga Kuvendi i Kosovës.
Këshilli përbëhet nga mbikëqyrësi kryesor shtetëror dhe katër mbikëqyrës shtetërorë.

Gjatë vitit 2013 Këshillit të Agjencisë ka mbajtur 20 mbledhje. Sipas detyrave të përshkruara në Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale nga këto mbledhje janë nxjerrë 30 vendime, prej tyre:

- 2 vendime për dhënien e autorizimit për transferim të të dhënave,
- 4 vendim për dhënie të opinionit ,
- 24 vendime administrative

5.1.2 Departamentet

Departamentet e kryejnë punën e tyre ne përputhje të obligimeve që dalin nga Ligji 03/L-172; Rregullorja e Punës së Agjencisë dhe legjislacionit në fuqi, në mbështetje të punës së Këshillit.

Për kryerjen e punëve profesionale dhe administrative, fushëveprimi i të cilave është i përcaktuar me legjislacionin në fuqi; Agjencia punën e vet e ka të organizuar përmes departamenteve në këto dy fusha:

- Fusha e Administratës

- Fusha Profesionale - Operacionale

Personeli i punësuar në Agjenci, gjatë ushtrimit të kompetencave dhe autorizimeve ligjore, ka arritur të jetë mjaft transparent, profesional, efikas si dhe i pavarur e i paanshëm. Të punësuarit në Agjenci nuk ushtruan veprimtari politike përkundër zgjedhjeve lokale që u organizuan në vitin që e lëmë pas.

Bazuar në Rregulloren për Organizimin dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të nxjerr nga Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror, janë paraparë të jenë 37 zyrtar, kurse për vitin 2014 i kemi të miratuar vetëm 18 zyrtar (shërbyes civil).

Që nga koha e themelimit - qershor 2011, Agjencia ka funksionuar me një buxhet të kufizuar, numër të vogël të lejuar të personelit dhe për këtë arsye nuk janë funksionalizuar plotësisht ose nuk janë formësuar departamentet e parapara me strukturë organizative.

Përkundër kësaj, Agjencia për këtë kohë ka arritur në një masë të konsolidojë personelin profesional, duke qenë në përkushtim të vazhdueshëm për krijimin e një strukture me staf kompetent, profesionalisht të përgatitur me tendencën e vetme krijimin e një administrate efikase dhe profesionalisht të qëndrueshme.

Si shkak i numrit të vogël të personelit, zyrtarët janë të angazhuar deri në pesë funksione, duke arritur edhe certifikimin ne pjesën e shpenzimeve ku vlen të ceket se në vitin 2013 janë të certifikuar të gjithë zyrtarët që i parasheh ligji i financave dhe manuali i thesarit, përveç zyrtarit të prokurimit.

Agjencia, gjatë vitit 2013, në pamundësi që ti kryej me kapacitete të brendshme, procedurat e shpenzimeve buxhetore, ato i ka kryer përmes prokurimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Departamenti	**Nr i punëtorëve në Ligjin e buxhetit**	**Nr aktual i punëtorëve në fillim të 2013**		**Nr aktual i punëtorëve në fund të 2013**	
		Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar
Funksionar publik	**5**	**5**		**5**	
Admini. Qemdrore	15	11		14	
Total	20	16		19	

5.2 Këshilla dhe Opinione

Agjencia ka dhënë këshilla dhe opinione institucioneve publike dhe private për të gjitha çështjet lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, duke përfshirë edhe interpretimin dhe zbatimin e ligjit dhe të gjitha ligjeve dhe rregulloreve që parashohin përpunimin e të dhënave personale.

Gjatë vitit 2013, Agjencia ka dhënë 4 Opinione institucioneve publike dhe private lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale duke përfshirë interpretimin dhe zbatimin e ligjeve përkatëse.

Institucionet të cilat kanë kërkuar këshilla nga Agjencia në lidhje me çështjet e lartcekura janë:

- Administrata Tatimore e Kosovës,
- Banka Qendrore e Kosovës,
- Ministria Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
- Institucioni Mikrofinanciar FINCA

Lidhur me këtë po i veçojmë dy Opinionet të dhëna nga Agjencia:

- **Ministria e Kulturës, Rinis dhe Sportit - Qasjen në dosjet e kandidatëve për drejtor të teatrit kombëtar**

Agjencia ka pranuar një shkresë nga Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për dhënien e Opinionit lidhur me ligjshmërinë e qasjes në dosjet e kandidatëve (CV, letrën e motivimit, dhe dokumente te tjera që kandidatëve u kërkohen të paraqesin për konkurs), të cilët kanë konkurruar për pozitën e drejtorit të Teatrit Kombëtar në Prishtinë, të bërë nga Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese (BIRN).

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe duke u bazuar në ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale Agjencia ka dhënë mendim se nuk lejohet qasja në dosjet të kandidatëve (CV, letrën e motivimit, dhe dokumente te tjera që kandidatëve u kërkohen të paraqesin për konkurs) për postin e drejtorit të Teatrit Kombëtar në Prishtinë. Kjo me arsyetimin se të dhënat personale që gjenden në dosjet e përgjithshme të kandidatëve përmbajnë të dhëna personale të ndjeshme dhe të dhënave që nuk i shërbejnë qëllimit të transparencës, siç janë : numri i telefonit, e-mail adresa, statusi martesor, adresa, numri personal, konfirmimi nga gjykata që nuk ka pasur procedura penale ose kundërvajtëse kundër aplikantit, dhe se nuk ka dënime të mëparshme.
Nga ana tjetër duke u bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ku thuhet se "përpunimi është i nevojshëm për kryerjen e një detyre me interes publik,

Agjencia ka dhënë mendim se disa informata mbi kandidatët e cekur më lart mund ti jepen, si emri, kualifikimet, përvojën e punës, aftësi të tjera të tilla si aftësitë kompjuterike, gjuhë të huaja, etj. Duke pasur parasysh të gjitha që u thanë më përpara, Agjencia ka pasur një qëllim për të gjetur një ekuilibër në mes të mbrojtjes së të dhënave personale dhe interesit publik, dhe në bazë të kësaj, ka sjellë opinionin e cituar më lart.

- **Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës - Këshillë lidhur me lehtësimin e realizimit të raportimit ligjor të obligueshëm që kanë taksapaguesit e SHBA-ve ose nga ana e entiteteve të jashtme ku taksapaguesit e SHBA-ve kanë pronësi të theksuar**

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka pranuar një kërkesë nga Banka Qendrore e cila ka kërkuar një opinion lidhur me çështjen e mbrojtjes së të dhënave personale me rastin e raportimit të llogarive financiare të mbajtura nga shtetasit e SHBA-ve në bankat komerciale të Kosovës.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe duke u bazuar në ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale Agjencia ka dhënë opinionin se të të dhënat personale mund t'i transferohen dhe zbulohen vendit ose organizatës ndërkombëtare që nuk e siguron nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave, nëse është paraparë me ligj tjetër ose me marrëveshje ndërkombëtare detyruese ose subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e tij ose të saj dhe është i vetëdijshëm për pasojat e transferimit. Si rrjedhojë e kësaj që u tha më lartë Agjencia ka rekomanduar nënshkrimin e marrëveshjes bilaterale që rregullon këtë çështje.

Në kuadër të përgjegjësive, mbikëqyrësit shtetërorë, gjatë këtij viti kanë dhënë 26 këshilla institucioneve të ndryshme lidhur me zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
Institucionet të cilat kanë kërkuar këshilla nga Mbikëqyrësit Shtetëror në lidhje me çështjet e lartcekura janë:

- Ministria e Integrimeve Evropiane,
- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë,
- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale,
- Administrata Tatimore e Kosovës,
- Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave,
- Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik,
- Banka Qendrore e Kosovës,
- Dogana,
- TEB Banka ,

- Banka Ekonomike,
- Raiffeisen Banka,
- Banka Kombëtare Tregtare,
- ProCredit Banka,
- NLB Banka,
- Banka Private e Biznesit,
- Kompanitë e Sigurimeve,
- Spitalet private,
- Operatori i Telefonisë IPKO,
- Kuvendi Komunal i Gjilanit,
- Kuvendi Komunal i Novo Bërdes,
- Institutet Mikrofinanciare,
- Qytetarët
- Asistenca Teknike e Departamentit të Thesarit Amerikan në Ministrinë e Financave
- Qendra për Punë Sociale – Lipjan
- Ministria e Diasporës

Mbikëqyrësit Shtetërorë në vazhdimësi kanë dhënë këshilla të ndryshme gjatë inspektimeve dhe kontrolleve, vizitave që kanë bërë në vitin 2013.

5.2.1 Konsultim me Rastin e Hartimit të Masave Legjislative dhe Administrative

Në bazë të nenit 39 të Ligjit 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ku thuhet se Kuvendi i Kosovës dhe Qeveria e Kosovës duhet ta informojnë Agjencinë me rastin e hartimit të masave legjislative dhe administrative që kanë të bëjnë me përpunimin e të dhënave personale, Agjencia gjatë vitit 2013 ka shqyrtuar dhe ka dhënë mendimet e saj lidhur me ligjet dhe aktet tjera nënligjore që kanë ardhur për konsultim në Agjenci edhe atë: për 19 projektligje, 7 rregullore, 18 udhëzime administrative si dhe 9 akte të tjera përfshirë këtu memorandum shpjeguese, draft-marrëveshje, memorandum mirëkuptimi, koncept dokumente si dhe akte tjera administrative.
Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen të Dhënave Personale ka shqyrtuar dhe ka dhënë mendimin për këto akte:

5.2.2 Projekt – Ligje

1. Projektligjin për tregtinë me mallrat strategjike
2. Projektligjin për Mbikëqyrjen Elektronike të personave të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të Gjykatës ose të Panelit për lirimin me kusht.
3. Projektligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit.
4. Projekt për të Huajt
5. Projektligjin për Azil
6. Projektligjin për Bashkëpunimin Ndërmjet Autoriteteve të Përfshira në Menaxhimin e Integruar të Kufirit.
7. Projektligjin për transplantimin e indeve dhe qelizave.
8. Projektligjin për Inspektoratin Administrativ.
9. Projektligjin për Përgjimin e Telekomunikimeve.
10. Projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-019, për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuar.
11. Projektligjin për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent.
12. Projektligjin për Përgjimin e Telekomunikimeve.
13. Projektligjin për Transplantimin e Indeve dhe Qelizave.
14. Projektligjin për Inspektoratin Administrativ.
15. Projektligjin për Statusin e Punëtoreve te Arsimit shqiptar te Republikës se Kosovës nga viti shkollor 1990-1999.
16. Projektligjin për Plotësimin dhe Ndryshimin E Ligjit Nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
17. Projektligji për Ushqim.
18. Projektligjin për Shërbimin Mjekësor Emergjent.
19. Projektligjin për Shëndetin Mendor.

5.2.3 Projekt – Rregullore

1. Projekt-Rregullore për Organizimin dhe Operimin e Sistemit të Monitorimit, Njoftimit dhe Paralajmërimi.
2. Projekt-Rregullore për Hartimin e Regjistrit të Diasporës dhe Mërgatës.
3. Projekt-Rregulloren për trajnime të obligueshëm dhe provim të obligueshëm të nëpunësve civil.
4. Rregulloren për Funksionimin e Komisionit Mediko-Social dhe Procedurat e Aplikimit për Realizimin e të Drejtave për Personat e Verbër.
5. Projekt-Rregulloren për caktimin e Masave Ndëshkuese të parapara me Rregulloret 2008/3, 2008/5, 2010/1 dhe 02/2013.
6. Projekt-Rregulloren për Plotësim-Ndryshimin e Rregulloreve 2008/3 dhe 2008/4.

7. Projekt - Rregulloren Mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim.

5.2.4 Projekt - Udhëzime Administrative

1. Projekt-Udhëzimin Administrativ për Mënyrën dhe Metodologjinë e Përcjelljes së Emisioneve të Gazrave Serë.
2. Projekt-Udhëzimin Administrativ për Shpalljen e Rrjetit Ekologjik.
3. Udhëzimin Administrativ, Njësitë Organizative të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitare të Kosovës.
4. Udhëzim Administrativ për vendosjen e Banderolave në Produktet Medicinale që importohen, prodhohen dhe qarkullojnë në Republikën e Kosovës.
5. Udhëzim Administrativ mbi Autorizim të Marketingut për Plasimin e Produkteve Medicinale në Republikën e Kosovës.
6. Udhëzim Administrativ mbi Kërkesat e Praktikës së Mirë të Prodhimit.
7. Udhëzimin Administrativ për Caktimin e Çmimit të Produkteve dhe të Pajisjeve Medicinale.
8. Udhëzim Administrativ për Qarkulluesit me shumicë për produkte dhe pajisje Medicinale.
9. Udhëzimin Administrativ për Qarkulluesit me pakicë për produkte dhe pajisje Medicinale.
10. Udhëzimin Administrativ për linjat telefonike për ankesat e qytetarëve në ofrimin e shërbimeve shëndetësore.
11. Udhëzimin Administrativ per kushtet dhe procedurat e ndërrimit te emrit personal.
12. Udhëzimi Administrativ për Kategoritë e qytetarëve dhe banorëve të liruar nga bashkë-financimi.
13. Udhëzimin Administrativ për rregullat e trafikut lokal kufitar dhe lejen e trafikut lokal kufitar.
14. Udhëzimin Administrativ për mbikëqyrjen inspektuese për zbatimin e masave të mbrojtjes nga zjarri.
15. Udhëzimin Administrativ për Mënyrën e Themelimit dhe të Funksionimit të Inkubatorëve të Biznesit.
16. Udhëzimin Administrativ Për Përmbajtjen E Studimit Të Fizibilitetit.
17. Udhëzimin Administrativ për Përcaktimin e Procedurës së Paraqitjes së Kërkesës për Marrjen e Pëlqimit, Procedimit të saj dhe Dhënien e Pëlqimit si dhe Përmbajtja e Regjistrit të Zonave Ekonomike.
18. Udhëzimin Administrativ për Menagjimin e Mbeturinave nga Industria Ekstraktive dhe Minierave.

5.2.5 Akte të tjera

1. Memorandum i mirëkuptimit i lidhur ndërmjet Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Agjencisë për Regjistrim Civil.
2. Statutin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës.
3. Marrëveshjen Bashkëpunimi ndërmjet Doganës së Kosovë dhe Shoqatës së Eksportuesve të Kosovës (KEA).
4. Marrëveshjen e Bashkëpunimi ndërmjet Byrosë Kosovare të Sigurimit dhe Doganës së Kosovës për Shkëmbimin e të Dhënave mbi importin e automjeteve.
5. Draft-marrëveshjen në fushën e sigurimeve sociale në mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Austrisë.
6. Formularin për Komunikimin publik – MBP.
7. Memorandumi Shpjegues i Rregullores për Hartimin e Regjistrit të Diasporës dhe Mërgatës, si dhe Përditësimin e tij.
8. Plani korrektues për gjetjet e Raportit te Progresit.
9. Koncept dokument për hartimin e projektligjit për ndryshimin plotësimin dhe ndryshimin e ligjit nr. 04/l-57 për lirinë e asocimit në organizatat joqeveritare.

I gjithë legjislacioni primar dhe sekondar i cili rregullon përpunimin e të dhënave personale duhet të jetë në harmoni me nenin 36 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në kuadër të kësaj duhet potencuar se jo të gjitha ligjet e proceduara dhe të aprovuara kanë arritur për konsultim tek Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Në vitin 2012, në Agjenci për konsultim kanë arritur 4 Projekt-Ligje, 8 Projekt-Rregullore, 3 Projekt-Udhëzime Administrative si dhe 1 Draft-Marrëveshje, gjatë vitit 2013 ky numër është rritur dukshëm ku në Agjenci për konsultim kanë ardhur 19 Projekt-Ligje, 7 Projekt-Rregullore, 18 Projekt-Udhëzime Administrative, 12 akte të tjera përfshirë këtu memorandum shpjeguese,draft-marrëveshje, memorandum mirëkuptimi, koncept dokumente si dhe akte tjera administrative. Agjencia ka dhënë komentet e saj me qëllim të harmonizimit me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, mirëpo nuk ka arritur të marrë informacione se vërejtjet dhëna nga Agjencia janë marrë parasysh.

Duke marrë parasysh se në Kuvendin e Republikës së Kosovës gjatë vitit 2013 janë miratuar rreth 60 Ligje, na bënë të nënkuptojmë se një pjesë e madhe e këtyre ligjeve nuk kanë ardhur në konsultim. Agjencia rekomandon të respektohet neni 39 i Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ku thuhet se që Kuvendi i Kosovës dhe Qeveria duhet ta konsultoj Agjencinë para miratimit të masave legjislative dhe administrative që kanë të bëjnë me përpunimin e të dhënave personale.

5.3 Ankesat

Sipas Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, çdo person i cili konsideron se i është shkelur e drejta e tij ose e saj në privatësi në kuptim të të dhënave personale, mund të parashtrojë ankesë në Agjenci. Ankesat janë parashtruar gojarisht përmes telefonit, me shkrim dhe mjeteve elektronike. Agjencia po ashtu ka mundësuar që formulari për ankesë të shkarkohet nga ueb-faqja zyrtare.

Agjencia, gjatë vitit 2013 ka pranuar gjithsejtë 58 ankesa. Nga ky numër për 8 ankesa të qytetarëve është realizuar inspektim dhe është proceduar në harmoni me procedurat dhe Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Agjencia ka trajtuar 50 ankesa që ndërlidhen me rrjetin social Facebook. Ankesat kanë pasur te bëjnë kryesisht me profile te rrejshme. Rezultatet nuk janë shume të kënaqshme edhe pse me ndihme e zyrës së Facebook-ut për Evropë në Dublin janë mbyllur të gjitha rastet profilet e rrejshme, pas disa dite apo jave, nga te njëjtit persona kemi pranuar ankesa te njëjta. Qe donë te thotë se profilet e rrejshme janë rihapur.

Kryesisht qytetarët e Republikës së Kosovës janë ankuar për keqpërdorimin e të dhënave personale nga ana e kontrollorëve ku të dhënat e tyre janë keqpërdorur me qëllim të marketingut të drejtpërdrejtë, zbulimit të paautorizuar të të dhënave, përpunimi i të dhënave pa pëlqimin e subjektit, keqpërdorimin e të dhënave personale përmes rrjeteve sociale si dhe përpunimi i të dhënave jo të sakta.

Këto ankesa kanë qenë kryesisht të orientuara ndaj sektorit bankar, sektorit mikrofinanciar,kompanive të sigurimeve, operatorët e telefonisë mobile dhe KEK-ut, shtypit ditor dhe rrjeteve sociale.

Përkundër rritjes së vogël të numrit të ankesave, konsiderojmë se ankesat e qytetarëve drejtuar Agjencisë është edhe më tutje i vogël. Kjo pasqyron njohuri ende jo të mjaftueshme lidhur me të drejtat e tyre për mbrojtjen e të dhënave personale të cilëve ia garanton Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Mbesim të përkushtuar që gjatë vitit 2014 të fokusohemi në ndërgjegjësimin e qytetarëve për të drejtat e tyre.



5.3.1 Pyetjet e parashtruara nga subjektet fizike dhe juridike

Agjencia, gjatë vitit 2013 ka pranuar gjithsejtë 48 pyetje përmes ueb-faqes zyrtare të parashtruara nga qytetarët dhe subjektet e ndryshme juridike. Agjencia për të gjitha këto pyetje ka dhënë shpjegimet e duhura në harmoni me procedurat dhe Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Mundësia e lehtë e parashtrimit të pyetjeve nëpërmjet ueb-faqes zyrtare të Agjencisë, ka rezultuar me një numër dukshëm më të madh të pyetjeve në krahasim me vitin 2012.



5.4 Inspektimi dhe Kontrolli

Agjencia bën mbikëqyrjen e përpunimit të ligjshëm të të dhënave personale, i cili bëhet përmes inspektimeve dhe kontrolleve. Agjencia kryen inspektime të rregullta sipas detyrës zyrtare dhe në bazë të ankesave.

Agjencia ka kompletuar tërë kornizën e nevojshme për realizimin e inspektimeve dhe kontrolleve. Në kuadër të kësaj, Agjencia ka nxjerrë rregulloren për inspektim, listën e kontrollit dhe formularin e procesverbalit.

Agjencia kryen inspektime dhe kontrolle të rregullta dhe në bazë të ankesave. Gjatë vitit 2013 ka kryer 78 inspektime të rregullta në bazë të planit të punës, sipas detyrës zyrtare dhe sipas ankesës si dhe 14 kontrolle. Duke u bazuar në numrin e inspektimeve dhe kontrolleve të vitit paraprak dhe këtij viti del se numri i inspektimeve është rritur rreth 40% , ndërsa numri i kontrolleve është dukshëm më i madh.





5.4.1 Inspektimet

Inspektimet gjatë vitit 2013, kanë pasur këtë shtrirje sipas organeve:

- Organet publike qendrore 19
- Organet publike lokale 10
- Organet private 49





Sipas llojit të inspektimeve :

- Inspektime të rregullta 56
- Inspektime sipas ankesës 8
- Inspektime sipas detyrës zyrtare 14





5.4.2 Inspektime të Rregullta

Në kuadër të inspektimit të rregullt është mbikëqyrur ligjshmëria e përpunimit e të dhënave, siguria e të dhënave, sistemi i dosjeve, transferimi i të dhënave, marketingu i drejtpërdrejtë, vëzhgimi me kamerë, karakteristikat biometrike, regjistrimet e hyrjes dhe daljes nga ndërtesa, ndërlidhje e sistemeve, realizimi i të drejtës se subjektit të të dhënave personale, zyrtari i brendshëm i mbrojtjes së të dhënave personale.

Në vitin 2013 inspektime të rregullta janë realizuar sipas planit të punës për këtë vit. Sipas planit të vitit 2013 këto inspektime të rregullta janë orientuar në fushën e vëzhgimit me kamerë, regjistrimet e hyrjes dhe daljes në ndërtesa, përpunimi i të dhënave biometrike, përpunimi i të dhënave personale me qëllim të marketingut të drejtpërdrejt dhe transferimi i të dhënave personale tek shtetet dhe organizatat ndërkombëtare. Inspektimet në fushat e lartcekura janë realizuar në këto institucionet e mëposhtme:

1. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
2. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
3. Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
4. Kuvendi Komunal Novobërdë
5. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
6. Kuvendi Komunal Gjilan
7. Kuvendi Komunal Shtime
8. Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve
9. Kuvendi Komunal Mitrovicë
10. Kuvendi Komunal Skenderaj
11. Kuvendi Komunal Vushtrri
12. Spitali Regjional Prizeren
13. Kuvendi Komunal Kamenicës
14. Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik
15. KUR – Prishtinë
16. Viva Fresh Store-Prishtin
17. Gorenje Niti-Tiki Company Sh. A,

18. Uni free – Duty free – (Aeroporti Adem Jashari)
19. IMF – Kreditimi Rural i Kosovës
20. IMF – AFK
21. IMF – FINCA
22. IMF – KEP
23. IMF – Start
24. IMF – Kosinvest
25. IMF – Perspektiva 4
26. IMF – KAD – Kosovë
27. Fondi i Kursimeve Personale
28. Ministria e Financave
29. Administrata Tatimore e Kosovës
30. MF – Njësia e Intelegjencës Financiare
31. Agjencia Kosovare e Privatizimit
32. Banka Private e Biznesit
33. Banka Ekonomike
34. Banka Kombtere Tregtare
35. TEB Banka
36. NLB banka
37. ProCredit Bank
38. Raiffeisen Bank
39. Dogana e Kosoves
40. QKMF – Lipjan
41. Viva Fresh Store – Mitrovicë
42. Minimax Shoping Centre – Prishtinë
43. Fakulteti i Gjeoshkencave dhe i Teknologjisë – Mitrovicë
44. IPKO Telecomunications
45. Operatori i Telefonisë PTK -Sh. A. VALA
46. K.S. Croatia Sigurimi
47. K.S. Sigal

48. Klinika Kirurgjike Aloka
49. Sptali i Zemrës INTERMED
50. K.S. SIGKOS
51. Spitali Amerikan Prishtinë
52. K.S. SIGMA
53. Kavaja Hospital
54. Prince Coffe Shop (Aeroporti Adem Jashari)
55. Black and Red (Aeroporti Adem Jashari)
56. B and B Group L.L.C. (Aeroporti Adem Jashari)

Gjatë inspektimeve të organeve publike dhe private në fushat e lartcekura janë konstatuar parregullsi, për të cilat Agjencia në bazë të të gjeturave, ka nxjerrë vendime, me anë të cilave institucionet e lartcekura janë urdhëruar apo këshilluar për eliminimin e parregullsive të konstatuara.

Inspektimet e rregullta të realizuara sipas planit të punës të vitit 2013, të fokusuara në fushën e vëzhgimit me kamerë, regjistrimet e hyrjes dhe daljes në ndërtesa, përpunimi i të dhënave biometrike, përpunimi i të dhënave personale me qëllim të marketingut të drejtpërdrejt dhe transferimi i të dhënave personale tek shtetet dhe organizatat ndërkombëtare, janë realizuar në pothuajse të gjitha institucionet publike dhe private të vlerësuar nga Agjencia si përpunues të mëdhenj të të dhënave personale.

Në fushën e vëzhgimit me kamerë janë inspektuar institucionet e lartcekura dhe pas verifikimit të procedurave dhe dokumentacionit që kërkohet nga ligji, si dhe verifikimi i sistemeve të monitorimit të kamerave të cilat pasqyrojnë pozicionimin e kamerave, janë nxjerrë vendime me të janë urdhëruar apo këshilluar institucionet për zbatimin e ligjit në fushën e vëzhgimit me kamerë. Pas Inspektimit dhe më pastaj Kontrolleve mbi zbatimin e vendimeve mund të konstatojmë se institucionet e inspektuara kanë instaluar dhe vazhdojnë të përdorin sistemin e vëzhgimit me kamerë në harmoni me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Është me rëndësi të theksohet se të gjitha vendimet e nxjerra nga Agjencia për eliminim e parregullsive në fushën e vëzhgimit me kamerë janë zbatuar në përpikëri nga institucionet e lartcekura.

Regjistrimet e hyrje – daljeve nga ndërtesa po ashtu kanë qenë pjesë e planit të punës që të inspektohen në vitin 2013. Gjatë inspektimit janë gjetur parregullsi, që nga marrja e tepërt e të dhënave personale deri tek ruajtja e regjistrave mbi afatin e lejuar nga Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Për të gjitha institucionet e

inspektuara në të cilat janë gjetur këto parregullsi Agjencia ka nxjerrë vendime për eliminimin e tyre. Pas Kontrolleve mbi zbatimin e vendimeve mund të konstatojmë se institucionet e inspektuara mbajnë regjistra të hyrje-daljeve në ndërtesa nga ana e vizitorëve në harmoni me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Është me rëndësi të theksohet se të gjitha vendimet e nxjerra nga Agjencia për eliminim e parregullsive në fushën e regjistrimeve të hyrje-daljeve nga ndërtesa janë zbatuar në përpikëri nga institucionet e lartcekura.

Duke pas parasysh se të dhënat biometrike hyjnë në grupin e të dhënave personale të ndjeshme Agjencia ka vlerësuar që në vitin 2013 të bëjë inspektime në këtë fushë. Në të gjitha institucionet e inspektuara të cilat kanë përpunuar të dhëna biometrike, në harmoni me ligjin për Mbrojtjen e të dhënave Personale, agjencia ka dhënë autorizim për përpunim. Në të gjitha rastet tjera kur të dhënat biometrike janë përpunuar në kundërshtim me ligjin, Agjencia ka nxjerrë vendime përmes të cilave ka urdhëruar ndërprerjen e këtij përpunimi. Pas Kontrolleve mbi zbatimin e vendimeve mund të konstatojmë se institucionet e inspektuara përpunojnë të dhëna biometrike në harmoni me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Është me rëndësi të theksohet se të gjitha vendimet e nxjerra nga Agjencia për eliminim e parregullsive në fushën e përpunimit të të dhënave biometrike janë zbatuar në përpikëri nga institucionet e lartcekura.

Marketingu i drejtpërdrejtë përdoret mjaft shumë nga kompanitë private me qëllim të promovimit të produkteve dhe shërbimeve të tyre andaj Agjencia në planin e punës për vitin 2013 ka vendosur të inspektoj institucionet e lartcekura. Gjat inspektimit janë gjetur parregullsi, që nga dërgimi i e-maileve apo sms-ve pa marrjen e pëlqimit nga ana e klientit dhe deri tek dërgimi i ofertave të ndryshme qytetarëve që nuk kanë qenë klient të institucioneve përkatëse. Në këtë rast agjencia ka nxjerrë vendime përmes të cilave ka urdhëruar ndërprerjen e këtyre praktikave dhe në të njëjtën kohë ka këshilluar mënyrën ligjore të përdorimit të të dhënave personale me qëllim të marketingut të drejtpërdrejtë. Vlen të theksohen përmirësimet e dukshme të përdorimit të marketingut të drejtpërdrejt në sektorin bankar. Po ashtu është me rëndësi të theksohet se të gjitha vendimet e nxjerra nga Agjencia për eliminim e parregullsive në fushën e përpunimit të të dhënave personale me qëllim të marketingut të drejtpërdrejtë janë zbatuar me përpikëri nga institucionet e lartcekura.

Transferimi i të dhënave personale tek shtetet dhe organizatat ndërkombëtare është vlerësuar nga Agjencia si një sfidë me të cilën duhet të fillojmë të ballafaqohemi në vitin 2013. Me këtë rast institucionet e lartcekura janë inspektuar nëse ky transferim realizohet në harmoni me ligjin. Paraprakisht Agjencia ka marrë vendim mbi listën e shteteve me nivel të duhur të sigurisë së të dhënave personale. Parregullsitë në të cilat kemi hasur gjatë inspektimit të institucioneve të lartcekura janë përmirësuar pas vendimeve që Agjencia ka nxjerrë për eliminimin e tyre. Në këtë rast për të gjitha transferet që realizohen në vendet të cilat janë pjesë e listës së vendeve me nivel të

duhur të sigurisë janë këshilluar institucionet që kontratat apo marrëveshjet të harmonizohen me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ndërsa për transferimet e të dhënave personale të cilat realizohen në shtetet që nuk kanë nivel të duhur të sigurisë pas plotësimit të kritereve ligjore Agjencia ka dhënë autorizim. Pas kontrolleve të zbatimit të vendimeve mund të konstatojm se të gjitha institucionet e lartcekura transferimin i të dhënave personale tek shtetet dhe organizatat ndërkombëtare e realizojn në harmoni me ligjin. Është me rëndësi të theksohet se të gjitha vendimet e nxjerra nga Agjencia për eliminim e parregullsive në fushën e transferimin i të dhënave personale tek shtetet dhe organizatat ndërkombëtare janë zbatuar me përpikëri nga institucionet e lartcekura.

5.4.3 Inspektimet Sipas Ankesës

Agjencia, gjatë vitit 2013, pas analizimit dhe vlerësimit të ankesave ka realizuar tetë inspektime. Me qëllim të vërtetimit të pretendimeve të ankuesve, janë realizuar inspektimet në institucionet e mëposhtme:

1. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
2. Operatori VALA
3. Illyria Life
4. Ndërmarrja Gazetare Botuese "Zëri"
5. TEB Banka
6. JYSK
7. Rainbow
8. Agjensioni Eurokoha

Ankesat kanë qenë kryesisht të fushave të marketingut të drejtpërdrejtë, saktësisë së të dhënave, zbulimit të të dhënave si dhe përdorimin e të dhënave për qëllime tjera për të cilat janë grumbulluar, vëzhgimi me kamerë etj. Pas inspektimit të institucioneve të lartpërmendura, Agjencia ka nxjerrë vendime, me anë të cilave institucionet e lartcekura janë urdhëruar apo këshilluar për eliminimin e parregullsive të konstatuara.

Në të gjitha rastet ankuesit janë njoftuar me rezultatin e inspektimit si dhe me veprimet e ndërmarra nga ana e Agjencisë brenda mandatit të saj.

Është me rëndësi të theksohet që të gjitha vendimet e Agjencisë janë zbatuar dhe kanë pasur efekte në përmirësimin e praktikave joligjore sa i përket përpunimit të të dhënave.

5.4.4 Inspektimet sipas detyrës zyrtare

Agjencia, gjatë vitit 2013 ka realizuar katërmbëdhjetë inspektime sipas detyrës zyrtare. Inspektimet sipas detyrës zyrtare janë bërë kryesisht në bazë të informacioneve për shkeljet e mundshme të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave, kryesisht janë marrë nga mediumet dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë. Në kuadër të inspektimeve sipas detyrës zyrtare hyjnë edhe inspektimet të cilat bëhen me rastin trajtimit të kërkesave të organeve për marrjen e autorizimeve për përdorim të të dhënave biometrike, transferimin e të dhënave në vendet dhe organizatat ndërkombëtare që nuk sigurojn nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave personale të parapara me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Për secilin rast Agjencia ka realizuar inspektime në institucionet e mëposhtme për të vërtetuar nëse institucioni përpunon të dhënat personale në harmoni me ligjin. Institucionet në të cilat janë bërë inspektime sipas detyrës zyrtare janë si më poshtë:

1.Ministria e Punëve të Jashtme, Ambasada në Tiranë,

2.KEK,

3.Ministria e Tregtisë dhe Industrisë,

4.K.S "Ilyria",

5.Operatori VALA,

6.City Park sh.a,

7.Institucioni Mikrofinanciar FINCA

8.BKT Banka

9.Spitali Regjional "Daut Mustafa"

10. Universiteti "Haxhi Zeka"

11. Kolegji Ndërkombëtar i Biznesit Mitrovicë

12. Spitali Regjional Gjilan.

13. Qendra për Punë Sociale Lipjan

14. Aeroporti Ndërkombëtar "Adem Jashari"

Inspektimet sipas detyrës zyrtare janë bërë në fushat e vëzhgimit me kamerë, përdorimin e karakteristikave biometrike, qasja në të dhënat personale, marketingu i drejtpërdrejtë, transferimi i të dhënave personale etj. Pas inspektimit të institucioneve të lartpërmendura, Agjencia ka nxjerrë vendime, me anë të cilave institucionet e lartcekura janë urdhëruar apo këshilluar për eliminimin e parregullsive të konstatuara.

Vlen të theksohet se të gjitha vendimet e nxjerra nga Agjencia për eliminim e parregullsive në fushat e inspektuara janë zbatuar me përpikëri nga institucionet e lartcekura.

5.4.5 Kontrollet

Agjencia gjatë vitit 2013 ka realizuar gjithsejtë katërmbëdhjetë kontrolle. Kontrollet janë realizuar në institucionet në të cilat pas inspektimit janë nxjerrë vendime përmes të cilave është urdhëruar eliminimi i shkeljeve. Në rastet kur Agjencia ka nxjerrë vendime përmes të cilave institucioni është këshilluar në eliminimin e parregullsive të vogla Agjencia nuk ka realizuar kontroll pasi që institucioni ka përmbushur këshillën dhe në formë të shkruar është dëshmuar në zbatimin e këshillës.

Institucionet në të cilat Agjencia ka realizuar kontrolle janë si në vijim:

1. Ministria e Zhvillimit Ekonomik
2. Ministria e Integrimeve Evropiane
3. Ministria e Administratës Publike – IKAP
4. Këshilli i Pavarur për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës
5. Agjencia Kosovare e Privatizimit
6. Ministria e Financave – Njësia e Inteligjencës Financiare
7. Viva Fresh Store – Prishtinë
8. Gorenje Niti-Tiki Company
9. Uni Free – Duty Free – Aeroporti Ndërkombëtar "Adem Jashari"
10. Kolegji VICTORY
11. N.G.B. "Zëri"
12. Minimax Shopping Centre – Prishtinë
13. Ministria e punëve të Jashtme – Ambasada Tiranë
14. KEDS



5.4.6 Përpunimi i të dhënave biometrike

Në bazë të Ligjit për Mbrojtje të Dhënave Personale të dhënat biometrike konsiderohen të dhëna personale të ndjeshme dhe si të tilla ato duhet të mbrohen në mënyrë të veçantë dhe të klasifikohen me qëllim të parandalimit të qasjes dhe përdorimit të paautorizuar.

Sektori publik dhe privat mund ti përdorë karakteristikat biometrike vetëm nëse është e domosdoshme për sigurinë e njerëzve, sigurimin e pronës ose mbrojtjen e të dhënave konfidenciale dhe sekreteve të biznesit.

Në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, vlerësimin e domosdoshmërisë së përdorimit të të dhënave biometrike e bën Agjencia përmes dhënies së autorizimit për përdorim, përveç rasteve të parapara me ligj.

Të gjitha organet publike dhe private të cilat dëshirojnë të përpunojnë të dhënat biometrike, përveç rasteve të parapara me ligj, para përdorimit të dhënave biometrike duhet marrë autorizimin nga Agjencia në harmoni me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Në vitin 2013 Agjencia ka pranuar dy kërkesa për marrjen e autorizimit për përdorimin e karakteristikave biometrike:

- **Aeroporti Ndërkombëtarë "Adem Jashari"** ka kërkuar autorizim për përdorimin e karakteristikave biometrike për kontrollin e qasjes në hapësirat e zonës neutrale të aeroportit.
    - Agjencia ka shqyrtuar dokumentacionin e ofruar, ka kryer inspektimin në harmoni me procedurat e brendshme dhe ka konstatuar se janë plotësuar kriteret e parapara me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Agjencia ka nxjerrë vendimin me anën e të cilit është dhënë autorizimi për përdorimin e karakteristikave biometrike në hapësirat e lartshënuara.

Në të gjitha institucionet e inspektuara të cilat kanë përpunuar të dhëna biometrike, në harmoni me ligjin për Mbrojtjen e të dhënave Personale, agjencia ka dhënë autorizim për përpunim. Në të gjitha rastet tjera kur të dhënat biometrike janë përpunuar në kundërshtim me ligjin, Agjencia ka nxjerrë vendime përmes të cilave ka urdhëruar ndërprerjen e këtij përpunimi. Pas Kontrolleve mbi zbatimin e vendimeve mund të konstatojmë se institucionet e inspektuara përpunojnë të dhëna biometrike në harmoni me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Është me rëndësi të theksohet se të gjitha vendimet e nxjerra nga Agjencia për eliminim e parregullsive në fushën e përpunimit të të dhënave biometrike janë zbatuar në përpikëri nga institucionet e inspektuara.

5.5 Transferimi i të Dhënave Personale

Në harmoni me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, transferimi i të dhënave personale, të cilat janë përpunuar ose ato që do të përpunohen në vende të tjera apo në organizata ndërkombëtare, mund të bëhet vetëm nëse këto vende sigurojnë nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave. Për të gjitha ato vende apo organizata ndërkombëtare të cilat nuk sigurojnë nivelin e duhur të mbrojtjes së të dhënave, organi publik apo privat që dëshiron të bëjë transferim të të dhënave, duhet të ndjekë procedurat e marrjes së autorizimit nga Agjencia.

Agjencia ka të aprovuar legjislacionin sekondar me të cilin rregullohen procedurat e transferimit të të dhënave personale jashtë vendit. Në kuadër të këtij legjislacioni sekondar Agjencia ka të aprovuar rregulloren mbi procedurat e brendshme të shqyrtimit të kërkesave për lejimin e transferimit ndërkombëtar të të dhënave personale, si dhe formularin i cili duhet të plotësohet me rastin e kërkesës nga ana e institucionit për transferimin e të dhënave.

Me qëllim të përmbushjes së obligimit ligjor si dhe për të kontribuar në krijimin e lehtësive për transferimin e të dhënave, Agjencia përmes një vendimi formal, ka listën e vendeve që sigurojnë nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave personale dhe për të njëjtat vende nuk kërkohet marrje e autorizimit nga ana e Agjencisë.

Lista e mëposhtme në vazhdimësi do të përditësohet me vendet dhe organizatat ndërkombëtare me nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave.

Lista e vendeve të Bashkimit Evropian të cilat sigurojnë nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave personale:

- Austri
- Belgjikë
- Britani e Madhe
- Bullgari
- Danimarkë
- Estoni
- Finlandë
- Francë
- Gjermani
- Greqi
- Holandë
- Hungari
- Irlandë
- Itali
- Letoni
- Lituani
- Luksemburg
- Maltë
- Poloni
- Portugali
- Qipro
- Republika Çeke
- Rumani
- Sllovaki
- Slloveni
- Spanjë
- Suedi

Shtetet anëtare të "Zonës Ekonomike Evropiane" të cilat sigurojnë nivel të duhur të mbrojtje së të dhënave personale:

- Islandë
- Lihtenshtein
- Norvegji
- Zvicër

Vendet dhe organizatat ndërkombëtare të cilat të cilat sigurojnë nivel të duhur të mbrojtje së të dhënave personale:

- Izrael
- Uruguaj

Në harmoni me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka publikuar listën në Gazetën Zyrtare dhe në faqen publike të Agjencisë.

Agjencia, në të gjitha rastet kur bën inspektime, verifikon nëse kontrolluesi bën transferim të të dhënave jashtë vendit dhe se i njëjti realizohet në përputhje me dispozitat e ligjit. Agjencia mund të ketë një pasqyrë të përgjithshme sa i përket transferimit të të dhënave personale kur të përfundojë regjistrimin e dosjeve të kontrollueseve.

Në vitin 2013 Agjencia ka pranuar dy kërkesa për transferimin e të dhënave personale dhe ka dhënë dy autorizime për transferimi e të dhënave personale:

- **Banka Ekonomike Sh.A.** ka kërkuar autorizim për transferim të të dhënave personale në **Compassplus LTD-Processing Center** me seli në Federatën Ruse (Rusia).

  Pas shqyrtimit të dokumentacionit të ofruar nga kërkuesi, Agjencia ka konstatuar se janë plotësuar kriteret të parapara në dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe ka lejuar autorizimin për transferimin e të dhënave personale të klientëve në kompanitë e lartcekura.

- **Banka TEB Sh.A.** ka kërkuar autorizim për transferim të të dhënave personale në **TEB HOLDING AS TURKEY** me seli në Republikën e Turqisë.

  Pas shqyrtimit të dokumentacionit të ofruar nga kërkuesi, Agjencia ka konstatuar se janë plotësuar kriteret të parapara në dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe ka lejuar autorizimin për transferimin e të dhënave personale të klientëve në kompanitë e lartcekura.

Pas kontrolleve të zbatimit të vendimeve mund të konstatojm se të gjitha institucionet e inspektuara gjat vitit 2013 në lidhje me transferimin i të dhënave personale tek shtetet dhe organizatat ndërkombëtare e realizojn në harmoni me ligjin. Është me rëndësi të theksohet se të gjitha vendimet e nxjerra nga Agjencia për eliminim e parregullsive në fushën e transferimin i të dhënave personale tek shtetet dhe organizatat ndërkombëtare janë zbatuar me përpikëri nga institucionet e inspektuara.

5.6 Informimi dhe Promovimi

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale rëndësi të posaçme i ka kushtuar marrëdhënieve me publikun. Në këtë kuadër të gjitha mediumet e shkruara dhe elektronike vendore kanë qenë të informuara me kohë për çdo aktivitet të planifikuar nga Agjencia, duke shfrytëzuar për këtë web faqen e Agjencisë si dhe kontaktet e drejtpërdrejta.

Agjencia ka organizuar konferenca, seminare, trajnime dhe punëtori me organet publike dhe private me temat që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të dhënave personale.

Agjencia ka shënuar 28 Janarin – Ditën e Mbrojtjes së të Dhënave Personale, duke organizuar aktivitete me qëllim të informimit dhe promovimit të të drejtave për mbrojtjen e të dhënave personale. Me këtë rast përmes shtypit ditor ka shpërndarë 30 mijë fletëpalosje me çëllim të informimit dhe sensibilizimit për të drejtat e tyre të garantuara me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Me qëllim të promovimit të mbrojtjes së të dhënave personale, Agjencia në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në Nëntor të viti 2013 ka filluar fushatën ndërgjegjësuese me nxënësit e shkollave të mesme me temën 'Privatësia Ime'. Në kuadër të fushatës janë shpërndarë dhjetëmijë fletëpalosje për ndërgjegjësimin e nxënësve me të drejtat e tyre në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Kjo fushatë ka pas edhe karakteri garues, me këtë rast janë përzgjedhur punimet më të mira në art figurativ dhe letërsi. Fushata ndërgjegjësuese është planifikuar të përfundoj më 28 janar 2014, në Ditën e Mbrojtjes së të Dhënave Personale.

PRIVATËSIA NË SHKOLLË

Privatësia nga të tjerët

- Ti, mbase dëshiron që informatat tua personale (rezultatet e testit me emër, mbiemër dhe notë), të mos jenë të vendosura në korridoret e shkollave.

- Informatat që ndan me kujdestarin e klasës apo edhe me drejtorin e shkollës, psikologun etj., dëshiron që të mbeten konfidenciale.
- Nëse ti ruan me xhelozi privatësinë tënde, nuk do të thotë që ti nuk dëshiron të shoqërohesh (të kesh shoqëri).
- Privatësia është diçka personale; grupi me të cilin bashkëjeton është diçka sociale.
- Të dalësh me shoqëri e të argëtohesh, nuk të pengon të ruash privatësinë tënde.

Instalimi i Kamerave

- Garanton sigurinë e njerëzve dhe sigurinë e pronës (pasurisë);
- Çdokush që përdorë sistemet e vëzhgimit me kamerë, duhet të ketë gjithnjë njoftimin paraprak;
- Shenja paralajmëruese për vëzhgimin me kamerë duhet të jetë e dukshme, në mënyrë që subjekti të njoftohet me masat e aplikuara, pa vështirësi, më së voni kur të ketë filluar vëzhgimi me kamerë;
- Hapësira e vëzhguar me kamera duhet të jetë e kufizuar në përputhje me ligjin;
- Regjistrimet e kamerave kanë afat të kufizuar të ruajtjes së tyre.

www.amdp-rks.org
infomdp@rks-gov.net

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
MINISTRIA E ARSIMIT E SHËNDETËSISË E TEKNOLOGJISË
MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEHNOLOGIJE
MINISTRY OF EDUCATION SIENCE & TECHNOLOGY

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Državna Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka
National Agency for Protection of Personal Data

PRIVATËSIA IME

Çka nënkuptojmë me privatësi?

Gjithçka që ka të bëjë me ty personalisht, qoftë e dhënë subjektive apo objektive, nënkupton privatësinë tënde.

"Privatësia është pikërisht e drejta për të ruajtur kontrollin mbi informacionin që të përket ty. Të jesh i vetëdijshëm se shumë nga veprimet tua të përditshme lënë gjurmë, në atë mënyrë që zbulojnë detajet e personalitetit tënd, besimit tënd të brendshëm, gjëra që jo gjithmonë ti do që të tjerët t'i dinë."

Cilat janë disa nga të dhënat tua personale kryesore?

- Emri, mbiemri;
- Numri personal (Nr i ID), numri i indeksit (librezës shkollore), numri i tatimit, numri i telefonit, etj.;
- Adresa, data, vendi i lindjes;
- Fotografia, video-incizimet, zëri i incizuar, etj.

Të dhënat e ndjeshme (sensitive)?

- Të dhënat mbi origjinën (raca, etnia);
- Përkatësia fetare;
- Anëtarësia sindikale;
- Gjendja shëndetësore ose jeta (orientimi) seksuale;
- Dënimet penale ose të kundërvajtjet;

- Karakteristikat biometrike (gjurmët e gishtërinjve, retina e syrit, tiparet e fytyrës, ADN, etj).

Cilat janë të drejtat tua?

- Të informohesh nëse të dhënat tua përdoren (përpunohen) në një formë ose tjetër;
- Të japësh pëlqimin tënd për përpunimin e këtyre të dhënave;
- Të mund të kundërshtosh përpunimin e të dhënave tua në rrethana të caktuara;
- Të ankohesh kur mendon se të dhënat tua përpunohen në kundërshtim me ligjin;
- Të ndryshosh ose të fshish të dhënat tua, kur ato janë të pasakta ose të paplota;
- Të kërkosh kompensimin e dëmit të shkaktuar si rezultat i përpunimit të paligjshëm të të dhënave.

Mbrojtja e të dhënave dhe privatësisë

- Janë të drejta të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe më Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
- Në Kosovë ekziston institucioni përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale.
- Ti mund të parashtrosh ankesë në Agjencinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale përmes:
  - postës elektronike;
  -me shkrim (duke plotësuar formularin në ueb faqe të Agjencisë:www.amdp-rks.org)
  - përmes telefonit;
  - personalisht etj.

PRIVATËSIA DHE RRJETET SOCIALE

- Mënyra më e shpejtë e përhapjes së të dhënave personale, njëkohësisht edhe mundësia me e lehtë e keqpërdorimit të tyre.

Disa prej rrjeteve sociale më të përhapura në botë:

- Facebook, My Space, Hi5, Flicker, Skyrock, Friendster, Tagged, Twiter, Windows Live, Badoo.com etj.

Përdorimi i drejtë i rrjeteve sociale

- Respekto të tjerët - Mos publiko asnjëherë informacione personale dhe foto të personave të tjerë pa pëlqimin e tyre!
- Kontrolloni veten - Mendo mirë para se të publikosh të dhënat tua personale, mbi të gjitha, emrin, adresën, numrin e telefonit në rrjete të ndryshme, si: *Facebook, Chat Rooms* të ndryshme etj., dhe mos prano lirshëm (pa i verifikuar) kërkesat për miqësi!

Vini re!

- Duhet të kesh kujdes, sepse fotografitë dhe informacionet e publikuara dikur, falë teknologjisë së zhvilluar të kërkimit (google, yahoo etj.) mund të rikthehen, edhe pasi t'i kesh fshirë.
- Duhet ditur se lundrimi në internet lë gjithmonë gjurmë (adresa e IP-së, historiku i lundrimit, emrat kyç të kërkuar në motorët e kërkimit). Çdo klikim i yti është një e dhënë që ti lë. Ti mund të fshihesh pas një pseudonimi, por jo pas një adrese të IP-së.

PRIVATËSIA NË FAMILJE

- Prindërit, nga dëshira e madhe për t'i ofruar siguri fëmijëve, mundohen të kontrollojnë gjithçka rreth tyre.

- Privatësia i takon gjithsecilit - edhe ty.

- Ty të lejohet të përdorësh - shfrytëzosh teknologjinë elektronike, televizorin, telefonin, kompjuterin, rrjetet sociale etj.

- Kuptohet, e gjithë kjo liri shkon deri aty sa mos të kesh pasoja nga keqpërdorimet e shumta që mund të ndodhin në vorbullën e quajtur teknologji - internet.

Fletëpalosja "Privatësia Ime"

Me qëllim të ndërgjegjësimit të institucioneve për obligimet ndaj Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Agjencia ka organizuar seminare ndërgjegjësuese. Në seminaret ndërgjegjësuese të organizuara nga Agjencia, pjesëmarrës kan qenë të gjithë zyrtarët e lartë të institucioneve publike dhe private të cilët në një formë apo formë tjetër kanë qasje në të dhëna personale. Pas suksesit të këtyre seminareve ndërgjegjësuese në vitin 2012 dhe në vitin 2013 Agjencia do të vazhdojë të organizoj këso seminare edhe në vitet në vazhdim pasi që kjo qasje pro aktive e Agjencisë ka treguar sukses në zbatim të ligjit.
Institucionet të cilat kanë kërkuar organizimin e seminareve ndërgjegjësuese janë si në vijim:

- Komisioni Qendror Zgjedhor
- Banka Qendrore e Kosovës
- Ministria e Kulturës, Rinis dhe Sportit
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
- Kuvendi Komunal - Kamenicë
- Kuvendi Komunal - Gjilan
- Institucioni Mikrofinanciar – FINCA
- Institucioni Mikrofinanciar – KOSINVEST
- Institucioni Mikrofinanciar - KRK
- Institucioni Mikrofinanciar - START
- Institucioni Mikrofinanciar - AKF

Agjencia, me qëllim të informimit dhe promovimit në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në vazhdimësi ka shprehur gatishmërinë për të organizuar apo marrë pjesë në çdo aktivitet të organizuar nga organet publike dhe private. Vlenë të theksohet se interesimi, sidomos i organeve private për të organizuar seminare të kësaj natyre ka qenë mjaft i madh.

Me qëllim që qytetarët të jenë të informuar me të drejtat e tyre, për sa i përket mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë, Agjencia, ka lansuar dy spote televizive me karakter senzibilizues njëri prej të cilëve i është dedikuar subjekteve kontrolluese, respektivisht vetëdijesimit të qytetarëve rreth rëndësisë së mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë.

Fig 1 - Spoti 1.

Fig 2 - Spoti 2.

Po ashtu edhe në aspektin e paraqitjeve mediale, Agjencia ka qenë prezente edhe në mediumet elektronike dhe në ato të shkruara, krejt kjo me qëllim të sensibilizimit të

opinionit publik për nevojën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe rolin dhe aktivitetet e Agjencisë në këtë fushë.

Gjatë vitit 2013 me tema të ndryshme të mbrojtjes së të dhënave personale, janë bërë me dhjetëra publikime të ndryshme që kanë pasur për qëllim informimin dhe promovimin e të drejtave për mbrojtjen e të dhënave personale.

Përkundër një paraqitjeje sistematike në mediumet e shkruara dhe ato elektronike, vlerësojmë se ende mbetet shumë punë për të bërë, në mënyrë që qytetarët të informohen për të drejtat e tyre në sferën e mbrojtjes së të dhënave personale. Kjo aq më parë që sipas disa hulumtimeve të bëra në sferën e sigurisë, informimi i qytetarëve sidomos në pjesët rurale të vendit është ende në nivel të ulët. Si rrjedhojë e kësaj senzibilizimi i opinionit jo vetëm nëpërmjet mjeteve të informimit, por edhe me kontakte të drejtpëlrdrejta me qytetarët, të jetë permanent dhe frytdhënës.

Kemi konstatuar se funksionalizimi i faqes zyrtare të Agjencisë ka ndikuar në senzibilizimin e mbrojtjes së të dhënave për të gjithë ata që kanë pasur mundësi të informohetn përmes kësaj web faqeje.

Web faqja zyrtare e Agjencisë është **www.amdp-rks.org**, ndërsa adresa zyrtare informuese është **info.amdp@rks-gov.net**.

5.7 Bashkëpunimi Vendor dhe Ndërkombëtar

Në përmbushje të obligimeve dhe detyrave ligjore, marrë në përgjithësi në fushën e bashkëpunimit për mbrojtjen e të dhënave personale, Agjencia ka qenë aktive si në bashkëpunimin e brendshëm po ashtu edhe atë ndërkombëtar.

Agjencia, në objektivat e vitit 2013, mes tjerash, në fokus ka pasur vënien e kontakteve dhe bashkëpunimit në nivel ndërkombëtarë dhe organet e Bashkimit Evropian. Posaçërisht pjesëmarrja në Konferencën Pranverore të Autoriteteve Evropiane për Mbrojtjen e të Dhënave, të organizuar nga autoriteti Portugez në Maj 2013, në Lisbonë të Portugalisë ishte domethënëse. Pas përmbushjes së kritereve të paracaktuara nga komisioni vlerësues i kërkesave të autoriteteve të interesuara për pjesëmarrje dhe anëtarësim, Agjencia u pranua si vëzhguese e përhershme në këtë konfernecë.

Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2013 dhe pas një angazhimi të gjithanshëm të Agjencisë, kemi arritur të anëtarësohemi me të drejta të plota në Konferencën 35-të Ndërkombëtare të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë, që këtë vit është mbajtur në Varshavë të Polonisë.
Agjencia, në objektivat e vitit 2013, mes tjerash, si detyrë parësore ka pasur vazhdimin e kontakteve dhe bashkëpunimin me Agjencitë homologe të rajonit dhe më gjerë.

Në kuadër të kësaj, Agjencia ka zhvilluar vizita në:

- Institucionin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Shqipërisë ;
- Agjencinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Maqedonisë;
- Agjencinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Kroacisë;
- Agjencinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Bullgarisë

Në saje të shtrirjes së bashkëpunimit dypalësh, gjatë periudhës njëvjeçare, Agjencia ka realizuar një vizitë në selinë e autoritetit homolog Bullgar. Takimi kishte për qëllim njohjen me përvojat e autoritetit Bullgar për mbrojtjen e të dhënave personale. Gjatë kësaj vizite janë shqyrtuar praktikat e institucionit për mbrojtjen e të dhënave personale të bullgaris me trajtimin e ankesave dhe aktivitetet kontrolluese.

Me qëllim të përforcimit të bashkëpunimit me autoritetet homologe të rajonit, në tetor 2013 është realizuar vizita në Drejtorinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Maqedonisë, duke trajtuar temën kryesore shkëmbimi i përvojave më të mira midis dy autoriteteve. Me qëllim të rritjes së bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave të autoriteteve rajonale për mbrojtjen e të dhënave personale Bashkimi Evropian përmes programit t ë TAIEX-it, ka organizuar konferencën rajonale me

temën "Interneti dhe mbrojtja e të dhënave personale", të mbajtur në Zagreb të Kroacisë.

Duke e pasur parasysh numrin e madh të ankesave në lidhje me keqpërdorimin e të dhënave personale në rrjetin social Facebook, Agjencia është angazhuar që të realizoj një takim me qëllim të trajtimit të këtyre shkeljeve. Pas kontakteve të shumta me përfaqësuesit e Facebook-ut për Evropë me seli në Dublin të Irlandës, në selinë e ASHMDHP-së u mbajt një video konferencë me ekspertët e sigurisë të rrjetit social Facebook. Gjatë kësaj konference u shtjelluan tema rreth çështjeve të sigurisë të përdoruesve të Facebook-ut, rreth mundësive të keqpërdorimit të privatësisë në këtë rrjet social si dhe mundësisë së evitimit dhe parandalimit të shkeljeve së privatësisë nga keqpërdorues të ndryshëm. Konferenca zgjati rreth tre orë dhe u dakorduam për formën e bashkëpunimit në eliminimin e keqpërdorimit të të dhënave personale të qytetarëve të Republikës të Kosovës në rrjetin social Facebook.

Përveç bashkëpunimit me autoritetet e shteteve tjera, Agjencia, gjatë këtij viti ka qenë e përqendruar në përforcimin e lidhjeve me institucionet e shtetit tonë. Në këtë aspekt, vlen të nënvizohet nënshkrimi i memorandumit të mirëkuptimit midis ASHMDHP dhe Ministrisë së Forcës së Sigurisë lidhur me koordinimin e aktiviteteve trajnuese për realizimin e misionit të të dyja institucioneve.
Në vitin 2013 janë realizuar me dhjetëra kontakte në konferenca, seminare dhe punëtori me organizatat homologe të vendeve të rajonit, me të cilat kemi nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi.

5.8 Caktimi i Zyrtarit Mbrojtës

Agjencia me qëllim të kompletimit të kornizës ligjore, sa i përket caktimit të zyrtarit të mbrojtjes së të dhënave - ZMDH dhe në harmoni me zhvillimet evropiane në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, me theks të veçantë të caktimit të zyrtarit të mbrojtjes së të dhënave, ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ për Caktimin e Zyrtarit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Agjencia konsideron se caktimi i zyrtarit të mbrojtjes së të dhënave është me rëndësi të veçantë si për institucionin i cili e cakton atë, ashtu dhe për Agjencinë. Gjatë përvojës dy vjeçare, kemi konstatuar se të gjitha institucionet të cilat kanë caktuar ZMDH-të, jo vetëm që kanë treguar përkushtimin e respektimit të dispozitave ligjore për përcaktim të zyrtarit, por është vërejtur dhe vullneti i tyre për bashkëpunimin e mëtutjeshëm në respektimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Duke veçuar me këtë rast dhe angazhimin e madh të shumicës së ZMDH-së për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të privatësisë, që jo rrallë ka rënë ndesh me politikat e organit të cilin e ka përfaqësuar.

Duke parë produktivitetin që sjell caktimi i ZMDH-së, Agjencia ka drejtuar me dhjetra shkresa dhe ka mbajtur me dhjetëra takime, jo vetëm për të bindur organet për zbatimin e dispozitave ligjore por për t'u shpjeguar rëndësinë që ka ZMDH në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtës për mbrojtjen e të dhënave dhe privatësisë.

Angazhimi ynë në këtë drejtim ka sjellë më shumë fryte tek organet private se tek ato publike. Në veçanti hasim në një neglizhencë të organeve publike të nivelit lokal në caktimin e ZMDH-së. Mbesim të përkushtuar në organizimin dhe mbajtjen e takimeve me përgjegjësitë e organeve publike dhe private me qëllim të sqarimit të rëndësisë së caktimit të ZMDH-së.

Tabela 1, Regjistrimi i zyrtarëve për mbrojtjen e të dhënave personale të caktuar në institucionet publike / private në vitin 2013:

- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
- Instituti Pedagogjik
- Instituti Historisë
- Instituti Albanologjik
- Universiteti Shtetëror i Prizrenit
- Organi Shqyrtuese e Prokurimit
- Aeroporti Ndërkombëtarë i Prishtinës
- Kosova Aid And Developement
- Agjencioni për Financim në Kosovë
- Autoriteti Kosovar i Konkurrencës
- Komuna Dragash
- Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik

- Komuna Rahovec
- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
- Institucioni Mikrofinanciar Besëlidhja
- Komuna Lypian
- Kompania e Sigurimeve Illyria Sh. A.
- Institucioni Mikrofinanciar Start
- Koorporata Energjetike e Kosovës
- Kreditimi Rural i Kosovës
- Institucioni Mikrofinanciar Perspektiva 4
- Komisioni i Pavarur për Media
- Kompania e Ujësjellësit Rajonal PRISHTINA
- Kreditimi Rural i Kosovës
- Atlantic Capital Partners
- Komuna Hani i Elezit
- Komuna Gjilanit
- Komisioni Qenror Zgjedhor
- Komuna Kllokot
- Komuna Vitis
- OJQ KOSINVEST
- Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve
- Qendra për Shëndetësi dhe përkujdesje Sociale -Lypian
- Croatia Sigurimi
- Kosova e Re
- Grawe Elsig
- Dardania Sigurimi
- Sigma - Kompani Sigurimesh
- SIGKOS - Kompani Sigurimesh
- Qendra Kombëtare për Menaxhimin e Kufirit
- KEDS

Agjencia në bashkëpunim me MAP-IKAP ka organizuar trajnime për zyrtarët e mbrojtjes së të dhënave personale. Qëllimi i këtij aktiviteti, ishte ofrimi i njohurive në lidhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale për zyrtarët për mbrojtjen e të dhënave personale, të cilët janë zbatuesit e drejtpërdrejtë të ligjit si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë dhe ndërlidhja e këtyre zyrtarëve me Agjencinë. Objektivat kryesore të këtij trajnimit ishin: ofrimi i njohurive në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë, obligimet e institucioneve të tyre, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, konkretizimi i mënyrave të ligjshme të përpunimit të të dhënave personale dhe ofrimi i njohurive mbi format e përpunimit të të dhënave personale.

5.9 Regjistrimi i Dosjeve dhe Vëzhgimi me Kamerë

5.9.1 Regjistrimi i Dosjeve

Agjencia, në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e të dhënave Personale është e obliguar që të themeloj dhe të mbajë një regjistër të sistemit të dosjeve. Në përmbushjen e këtij obligimi ligjor Agjencia ka nxjerrë rregulloren për mënyrën e mbajtjes së regjistrit të sistemit të dosjeve dhe Formularin për regjistrimin e sistemit të dosjeve. Me përkrahjen e ekspertëve evropian të angazhuar nga projekti TAIEX-it është bërë zhvillimi i aplikacionit që do të mundësonte aplikimin dhe regjistrimin *online* të sistemit të dosjeve. Përkundër angazhimit të përbashkët, zhvillimi i aplikacionit ka marrë shumë kohë, duke shtyrë në këtë rast inicimin e fillimit të regjistrimit të dosjeve të kontrollorëve.
Pavarësisht realizimit të aplikacionit për regjistrim *online*, Agjencia ka qenë e gatshme të pranoj njoftimet për regjistrim nga ana e institucioneve publike dhe private gjatë fundit të vitit 2013.

5.9.2 Vëzhgimi me Kamerë

Me qëllim të respektimit të dispozitave ligjore të cilat rregullojnë vëzhgimin me kamerë në sektorin publik dhe privat, Agjencia, ka hartuar udhëzuesin për përdorimin e vëzhgimit me kamerë.

Agjencia, në kuadër të masave për informimin e lehtë të qytetarëve për hapësirat që vëzhgohen me kamerë ka nxjerrë formatin standard të aplikueshëm në tërë Republikën e Kosovës, për të gjitha organet publike dhe private.

Shenja Paralajmëruese Standarde

Aplikimi i njoftimit standard, ka për qëllim që qytetari të ketë mundësi të lehtë të familjarizohet me shenjën paralajmëruese për hapësirat e vëzhguara me kamerë. Janë shpërndarë 1090 shenja njoftuese sipas standardit të paracaktuar në 89 organe publike dhe private.

Agjencia ka konstatuar një tendencë të vazhdueshme për shfrytëzimin e mbikëqyrjes dhe vëzhgimit me kamerë, po ashtu në masë të madhe organet publike dhe private aplikojnë formatin standard të njoftimit për hapësirat të cilat vëzhgohen me kamerë.

Me qëllim të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit në fushën e vëzhgimit me kamerë Agjencia ka realizuar inspektime dhe kontrolle, pas të cilave janë nxjerrë vendime për dhënien e këshillave me qëllim të përdorimit të vëzhgimit me kamerë në harmoni me ligjin. Është me rëndësi të theksohet se të gjitha vendimet e nxjerra nga Agjencia për eliminim e parregullsive në fushën e vëzhgimit me kamerë janë zbatuar në përpikëri nga institucionet.

5.10 Financat dhe Buxheti - Aktivitetet nga ndarja buxhetore janar-dhjetor 2013

Bazuar në rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, në vitin 2013 ASHMDHP-së i është aprovuar buxheti i përgjithshëm në shumë prej **372,000.00 €** dhe grandi nga Qeveria Norvegjeze në shumën prej **9,593.00 €,** pra gjithsejtë buxheti i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2013 ishte **381,593.90 €**, i ndarë në kategoritë kryesore si në vijim:

Tabela 1.1 Buxheti i ASHMDHP-së, viti 2013

Përshkrimi	**Shuma €**
Paga dhe mëditje	160,000.00
Mallra dhe shërbime	159,593.90
Shpenzime komunale	12,000.00
Pasuritë Jofinanciare	50,000.00
Total	**381,593.90**

5.11 Shpenzimet Buxhetore

Financimi i aktiviteteve të ASHMDHP-së, sipas klasifikimeve ekonomike është paraqitur në tabelën e mëposhtme. Janë shpenzuar € **371,101.43** si në vijim:

Tabela 1.2 Buxheti i shpenzuar

Përshkrimi	**Shuma €**
Paga dhe mëditje	159,771.68
Mallra dhe shërbime	156,401.44
Shpenzime komunale	11,569.04
Pasuritë Jofinanciare	43,359.27
Total	**371,101.43**

Sipas kategorive ekonomike, shkalla e shpenzimeve buxhetore është e paraqitur në përqindje (%).

Tabela 1.3 Shpenzimet buxhetore të shprehura në %

Përshkrimi	**Buxheti**	**Shpenzimet**	**Shpenzimet në %**
Paga dhe mëditje	160,000.00	159,771.68	99.90%
Mallra dhe shërbime	159,593.90	156,401.44	95%
Shpenzime komunale	12,000.00	11,569.04	96.40%
Pasuritë Jofinanciare (kapitale)	50,000.00	43,359.270	86.70%
Total	**381,593.90**	**371,101.43**	**95%**

Tabelat në vazhdim pasqyrojnë shpenzimet e ASHMDHP-së sipas nënkategorive kryesore ekonomike.

Tabela 1.4. Pagat dhe mëditjet (personeli dhe Këshilli i ASHMDHP-së)

Paga dhe mëditjet	**Shuma €**
Paga neto	135,012.61
Tatim i ndalur në të ardhura personale	9,729.75
Kontribute pensionale të punëdhënësit	7,514.66
Kontribute pensionale të të punësuarve	7,514.66
Gjithsej paga dhe mëditje	**159,771.68**

Tabela 1.5. Mallrat dhe shërbimet

Përshkrimi	**Shuma**
Shpenzimet e udhëtimit	19,570.26
Shërbimet e telekomunikimit	7,212.30
Shpenzimet për shërbime	32,987.63
Mobiljet dhe pajisjet nën 1000 Euro	17,869.02
Shërbimi për sigurimin e automjeteve	516.52
Derivatet dhe lëndët djegëse	7,422.18
Qiraja	47,203.70
Shpenzimet e marketingut	7,620.00
Shpenzimet e përfaqësimit	10,845.14
Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	5,154.65
Gjithsej mallra dhe shërbime	**156,401.44**

Tabela 1.6. Shpenzimet komunale

Përshkrimi	**Shuma**
Rryma	3,904.41
Uji	3,914.27
Shpenzime të telefonisë fikse	3,400.00
Mbeturinat	350.30
Gjithsej shpenzime komunale	**11,569.04**

6. VLERËSIMET E PËRGJITHSHME DHE REKOMANDIMET PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Mbrojtja e të dhënave personale është shqetësim në rritje në nivelin global. Shqetësimin lidhur me cenimin e privatësisë e ka rritur, zhvillimi i shpejt i teknologjisë së informacionit, internetit, makinerive kërkuese, rrjeteve sociale etj. Si rrjedhojë e këtij zhvillimi, mbrojtja e të dhënave personale po bëhet gjithnjë e më sfiduese.

Agjencia ka zhvilluar disa aktivitete lidhur me ndërgjegjësimin e qytetarëve për të drejtat e tyre në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale dhe të privatësisë, mirëpo ende niveli i njohurive në lidhje me këto të drejta nuk është i kënaqshëm. Nga sa u tha më sipër, rrjedh se ndërgjegjësimi i qytetarëve lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale duhet të jetë përkushtim i vazhdueshëm i Agjencisë.

Niveli i njohurisë për të drejtat dhe obligimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nga ana e organeve publike dhe private, pas një aktiviteti të gjerë të Agjencisë, gjatë vitit 2013, konsiderohet se është i mirë. Deri te ky vlerësim arrijmë në bazë të nivelit të interesimit të shprehur përmes kërkesave për këshilla, mendime si dhe zbatimit të plotë të të gjitha vendimeve të nxjerra nga Agjencia. Me qëllim të ngritjes së nivelit të njohurive në lidhje me obligimet ligjore, nga ana e Institucioneve publike dhe private Agjencia do të vazhdoj me qasjen pro-aktive në dhënien e këshillave, seminareve ndërgjegjësuese etj.

Duke pasur parasysh natyrën e ankesave nga viti paraprak, Agjencia në planin e punës për vitin 2013 ka planifikuar inspektime në fushën e vëzhgimit me kamerë, përpunimin e karakteristikave biometrike, transferimin e të dhënave personale tek shtetet tjera dhe organizatat ndërkombëtare, marketingun e drejtpërdrejt dhe regjistrimet e hyrjes dhe daljes në ndërtesa. Inspektimet e lartcekura janë realizuar në sektorin publik dhe atë privat. Institucionet të cilat janë inspektuar mund të vlerësojmë se nuk kanë pasur shkelje të mëdha. Deri tek kjo është arritur me një bashkëpunim të madh që është realizuar në mes të Agjencisë dhe zyrtarëve për mbrojtjen e të dhënave ne institucionet përkatëse. Ky bashkëpunim është realizuar në formën e takimeve konsultuese, seminareve ndërgjësuese, pyetjeve të shumta në lidhje me mënyrën e zbatimit të ligjit në fusha të caktuara etj.
Pas Inspektimeve të realizuara përmes procesverbaleve janë konstatuar shkeljet gjatë përpunimin të të dhënave personale të cilat përmes vendimeve është urdhëruar apo këshilluar që të njëjtat të eliminohen. Të gjitha vendimet e Agjencisë janë zbatuar nga ana e institucioneve të inspektuara, të cilave më pastaj ju është bëre një kontroll me qëllim të verifikimit të zbatimit të vendimeve. Si përfundim pas inspektimeve dhe kontrolleve mund të vlerësojmë që institucionet e inspektuara në fushat e lartcekura

janë duke përpunuar të dhënat ne harmoni me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Vlerësojmë se Zyrtarët për Mbrojtjen e të Dhënave Personale e kanë rolin kyç brenda institucioneve publike dhe private në zbatimin e ligjit. Në përmbushje të detyrimeve ligjore, me qëllim të ngritjes dhe forcimit të kapaciteteve në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, me rekomandim të Agjencisë dhe shqetësimeve të ardhura nga Raporti i Progresit ne fushën e Liberalizimit te Vizave gjatë vitit 2013, disa institucione publike kanë vendosur zyrtarin e mbrojtjes së të dhënave me detyrë parësore dhe me të vetmen detyrë në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, si: Ministria e Punëve te Brendshme (3), Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (1), Ministria e Punëve të Jashtme (1).

Rekomandojmë që në institucionet që janë përpunues të mëdhenj të dhënave personale si: Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Drejtësisë gjithashtu të caktojnë zyrtarët e mbrojtjes së të dhënave personale me të vetmen detyrë, ose ta ketë detyrë të parë dhe me prioritet në fushën e Mbrojtjes së të Dhënave Personale.

Mungesa e përcaktimit të specifikimeve te qarta të kategorive të të dhënave personale të nevojshme për përpunimin e të dhënave personale nga ana e organeve publike dhe private, është një ndër mungesat më të mëdha të legjislacionit në fuqi. Mungesa e këtij përcaktimi lë hapësirë që organet publike dhe private të mbledhin dhe grumbullojnë sasi të mëdha të të dhënave personale, që ato janë të panevojshme dhe në kundërshtim me parimet e përpunimit të të dhënave të përcaktuara me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Rekomandojmë që në të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore ku definohet përpunimi i të dhënave personale, të përcaktohen qartë kategoritë e të dhënave që do të përpunohen me atë rast.

Përpos mungesës së kornizës ligjore të qartë, që përcakton kategoritë e të dhënave që mundë të përpunohen, njëkohësisht në shumicën e rasteve mungon dhe koha e ruajtjes, ku si pasojë kemi grumbullimin dhe mbajtjen e të dhënave personale me vite të tëra përkundër arritjes së qëllimit për të cilën fillimisht janë grumbulluar.

Rekomandojmë që në të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore ku definohet përpunimin e të dhënave personale, të përcaktohet qartë koha e ruajtjes së të dhënave.

I gjithë legjislacioni primar dhe sekondar i cili rregullon përpunimin e të dhënave personale duhet të jetë në harmoni me nenin 36, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në kuadër të kësaj duhet potencuar se jo të gjitha ligjet e proceduara dhe të aprovuara në Kuvendin e Kosovës kanë arritur për konsultim në Agjenci.

Në vitin 2012, në Agjenci për konsultim kanë arritur 4 Projekt-Ligje, 8 Projekt-Rregullore, 3 Projekt-Udhëzime Administrative si dhe 1 Draft-Marrëveshje, kurse gjatë vitit 2013 në Agjenci për konsultim kanë ardhur 19 Projekt-Ligje, 7 Projekt-Rregullore, 18 Projekt-Udhëzime Administrative, 12 akte të tjera përfshirë këtu memorandum shpjeguese,draft-marrëveshje, memorandum mirëkuptimi, koncept dokumente si dhe akte tjera administrative. Agjencia ka dhënë komentet e saj aty ku kemi vërejtur se bëhet fjalë për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke marrë parasysh se në Kuvendin e Republikës së Kosovës gjatë vitit 2013 janë miratuar rreth 60 Ligje, na bënë të kuptojmë se një pjesë e madhe e këtyre ligjeve nuk kanë ardhur në konsultim.

Mbesim të përkushtuar që të japim kontributin në të gjitha rastet kur aktet ligjore apo nënligjore vijnë për konsultim në Agjenci. Në fakt ky është obligim ligjor që ka Agjencia për tu konsultuar nga Qeveria dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës me rastin e hartimit të masave legjislative dhe administrative që kanë të bëjnë me përpunimin e të dhënave personale.

Mos ratifikimi i Konventës 108 për Mbrojtjen e individit me rastin e përpunimit automatik të të dhënave personale, nga ana e Kuvendit te Kosovës e pamundëson Agjencinë që të anëtarësohet në organizmat Evropian dhe ndërkombëtarë në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Po ashtu në mungesë të ratifikimit të kësaj Konvente, Kosova nuk mund të jetë pjesë e listës së shteteve që sigurojnë nivel të duhur të Mbrojtjes së të Dhënave Personale në nivel të Bashkimit Evropian. Si rrjedhojë të transferimi i të dhënave personale në drejtim të Republikës së Kosovës hasë në vështirësi.

Rekomandojmë Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Kuvendit të Kosovës, që këtë ta fokusojnë si objektiv të vetin me prioritet, procedimin dhe Ratifikimin e Konventës 108 të vitit 1981.